



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AVOKATI I POPULLIT
Seksioni i Veçantë



Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315
E-mail: ap@avokatipopullit.gov.al
www.avokatipopullit.gov.al

Nr. Prot.
Nr. Dok. 201501458/4

Tiranë ___/___/2015

Lënda: Rekomandohet "Fillimi i hetimit të procedimit penal për veprën penale "Kryerja e veprimeve arbitrare" në bashkëpunim, parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal, në ngarkim të punonjësve të policisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve F. K., etj, në dëm të dënuarve R. H., B. Ç., F. B., dhe H. T., të cilët janë duke vuajtur dënimin në IEVP "Zahari" Krujë.

Drejtuar : Drejtuesit të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor
Z. Florian BONJAKU

K R U J Ë

Për dijeni : Prokurorit të Përgjithshëm
Z. Adriatik LLALLA

T I R A N Ë

I nderuar Z.BONJAKU,

Mbi ankesën e të dënuarit R. H., nga IEVP "Zahari" Krujë, të datës 29.07.2015, Avokati i Popullit ka urdhëruar kryerjen e një hetimi të pavarur administrativ, lidhur me pretendimin e tij se punonjësit e policisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve më datën 28.07.2015, kanë ushtruar dhunë fizike ndaj tij e të dënuarve të tjerë. Mbi këtë shqetësim në IEVP "Zahari" Krujë, më datën 30.07.2015, kanë shkuar një grup i Ndhmëskomisionerëve të Avokatit të Popullit.

Në vijim të hetimit administrativ janë kryer një sërë veprimesh të cilat kanë konsistuar në marrjen e marrjen e shpjegimeve të shtetasve të dëmtuar R.H., B. Ç., F. B., dhe H. T., janë marrë deklarime persononave që kanë dijeni për rastin në shqyrtim si, G. Sh., dhe F. T., janë administruar kartela klinike e të dënuarit B. Ç., dhe regjistri i vizitave të mjekut për të dënuarit datë 29 Korrik 2015.

Rrethanat e ngjarjes

Në datën 16.07.2015, është konstatuar humbja e pistoletës së policit të rregjimit të brëndshëm në IEVP “Zahari” Krujë, shtetasit S. R. Mbi këtë ngjarje Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë ka përgatitur materialin kallëzues dhe më datën 22.07.2015, e ka dërguar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Krujë.

Organi i Prokurorisë Krujë ka filluar procedimin penal nr.362 për veprat penale të “Mbajtjes pa lejë të armëve luftarake dhe municionit”, e “Shpërdorim detyre”, parashikuar përkatësisht nga nenet 278/2 dhe 248 të Kodit Penal.

Pas ndodhjes së kësaj ngjarje, më datën 28.07.2015, pas orës 20.00 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve me 8 grupe të përbërë nga katër punonjës policie secili, ka ushtruar kontroll në mjediset e rregjimit të brëndshëm të IEVP “Zahari” Krujë, bazuar në pikën 2 të nenit 124 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, pasi ekzistonte dyshimi i arsyeshëm për posedim të sendeve të ndaluara.

Veprimet e kryera **Baza për fillimin e çështjes penale**

Në shpjegimet e tij të datës 30.07.2015, i dënuar R. H., sqaron se: *“Më datë 28 Korrik 2015, rreth orës 21.45 isha në dhomë bashkë me shokët F. T., F. Ç., dhe K. Sh., kur kanë ardhur 7-8 policë të DAP-it bashkë me F. K., i cili qëndroi për pak kohë si shef policie në IEVP Krujë. U futën brënda në dhomë, nxorrën shokët bashkë me mua jashtë duke thënë se do t’ju bëjmë kontroll. Na kontrolluan në koridor dhe pastaj mua më vunë hekurat në duar duke më futur në dhomë me duar të lidhura. Policët më ulën në dyshe duke më thënë që kemi informacion se ti ke pistoletë dhe telefon, prandaj nxirri ku i ke. Pas kësaj më kanë qëlluar të gjithë më shkop gome tek shuajt e këmbës dhe me grushte sidomos pas koke, e tek nofulla në anën e majtë. Goditja me grushte e shkopinj vazhdoi 10-15 minuta. Para se të iknin shefi që quhet Fatmir dhe që ishte me uniformë civile, me këmishë me kuadrata të vogla më qëlloi me grusht në anën e brinjëve në krahun e djathtë duke më thënë se do të vi përsëri po u ankove...”*

I dënuari B. Ç., në shpjegimet e tij marrë më datë 30.07.2015, ka sqaruar se: *“Më datë 28 Korrik 2015 rreth orës 20.30 kam qënë duke ngrënë darkë bashkë me shokët e dhomës G. Sh., dhe G. D. Në këto momente kanë ardhur 3-4 policë të DAP-it të cilët na thanë që do të bëjmë kontroll. Ata na kontrolluan në koridor e pastaj tek dhoma e kursit. Pas kontrollit na futën në dhomë e na mbyllën derën. Janë kthyer pas 3-4 minutash dhe na pyetën për emrat. Pastaj nxorrën në koridor të dy shokët e mi, kurse mua më pyetën për emrin dhe për sende të paligjshme duke thënë se ti ke. Pastaj filluan të godasin 3-4 policë me grusht e shkop gome sidomos nga koka, ndonëse unë u mundova të mbrohem me duar duke qëndruar tek cepi i krevatit. Policët më kanë kapur dhe më gjuanin me shkop gome tek shputa e këmbës së djathtë, ndonëse ju thashë se e kam të dëmtuar...”*

Në shpjegimet e datës 30.07.2015, i dënuari F. B. (antar i Komunitetit Rom) sqaron se: *“Ka qënë datë 28 Korrik 2015, aty rreth orës 21.00 isha në dhomë me F. V., e Th. M., në sektorin “A”, kur kanë ardhur disa policë të DAP-it dhe*

thanë se do të bëjmë kontroll. Ata filluan kontrollin kur në dhomë erdhën dhe policët të tjerë me uniforma dhe një prej tyre më pyeti se nga je. Unë i thashë nga Tirana, kurse ai më tha që përse nuk thua që jam nga "Tirana" dhe më gjuajti me grushte në fytyrë e në stomak. Jam rrëzuar në tokë nga goditjet e në dhomë isha vetëm pasi dy shokët e mi i nxorrën në koridor. Pas goditjeve policët u larguan, por unë u ankova dhe pas pak kanë ardhur mjeku me infermjeren të cilët më vizituan dhe më bënë gjilpërë. Nga goditja me grusht në stomak unë u ula prej dhimbjes, ndërsa polici që nuk e njoh me emër, më qëllloi me gju në pjesën e dhëmbëve..."

I dënuari H. T., i cili e ka këmbën e djathtë me protezë, në shpjegimet e marra datë 30.07.2015, ndërmjet të tjerave sqaron se: *"Më datën 28 Korrik 2015, rreth orës 20.30 isha duke ngrënë bukë bashkë me shokun e dhomës K. S. Para portës së qelisë u shfaq policia e burgjeve që më bënë me dije se do të bënin kontroll. Ata ishin 4-5 punonjës, të cilët na nxorrën në koridor e na bënë kontroll fizik. Unë i vura në dijeni se kam këmbën e djathtë me protezë (me shufër hekuri), por ata nuk më kthyen përgjigje, përkundrazi më prangosën. Pa dhënë asnjë shpjegim lidhur se me çfarë objekti kishin ardhur, na trajtuan në një mënyrë jo humane e më pas më hoqën protezën e këmbës me pretextin se kisha fshehur diçka në këmbë".*

I dënuari F. T., në ditën e kontrollit nga Policia e Burgjeve, ka qënë në një dhomë me të dënuarin R. H., i cili për ngjarjen shpjegon se: *"...Pastaj morën R., i vunë hekurat në duar dhe e kanë futur në dhomë. Nuk dëgjova gjë, pasi policët mbyllën derën dhe sportelin. Policët qëndruan në dhomë me R., mbase 10 minuta dhe dolën. Kur jam futur në dhomë, R., më tha se policët më goditën duke kërkuar për thikë e pistoletë..."*

Ndërsa i dënuari G. Sh., i cili ndodhej në një dhomë me të dënuarin e dëmtuar B.Ç., në shpjegimet e tij të datës 30 Korrik 2015, sqaron se: *"... Na nxorrën në koridor mua me G., ndërsa B., e lanë në dhomë. I thonin B., që nxirr çfarë ke fshehur dhe filluan ta godasin me grushte e shkop gome, me këtë të fundit nga shputa e këmbëve. Unë i pashë nga dera që e kishin lënë hapur dhe një nga policët më qëllloi mua me grusht në kokë. Pasi ikën policët ne kërkuam mjekun, por ai nuk erdhi për të vizituar B."*

Nga kqyrja e regjistrit të vizitave të të dënuarve në I EVP "Zahari" Krujë datë 28.07.2015 deri në datën 29.07.2015, në numrin rendor 8 –tetë- figuron vetëm shtetasi F. B., marrë mjekim diazepam amp.1.

Tek kartela klinike nr.918 në emër të dënuarit F. B., datë 28.07.2015, ora 21.30, nga personeli mjekësor është shkruar: *"Pacientit referon se ka marrë goditje në pjesën abdominale..."* (bashkëlidhur kopje të fletëve të kartelës dhe regjistrit të vizitave)

Mendime dhe përfundime

Parë në tërësi veprimet e kryera nga punonjësit e policisë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve janë të parregullta dhe bien ndesh me nenin 5 të ligjit nr.8328 datë 16.04.1998 *"Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim*

dhe të paraburgosurve” i ndryshuar, ku thuhet: “Të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen me dinjitet dhe duke respektuar të drejtat njerëzore të tyre”. Ndërsa në nenin 57 të ligjit të mësipërm, i cili bën fjalë për Përdorimin e forcës dhe mjeteve shtrënguese thuhet : “ Nuk lejohet përdorimi i forcës fizike ndaj të paraburgopurve dhe të dënuarve, nëse nuk është e domosdoshme për të ndaluar aktet e dhunshme, tentativat e largimit nga institucioni si dhe për mposhtjen e kundërshtimit edhe kur ai është pasiv, në zbatim të urdhërave të dhëna”.

Në nenin 1 të ligjit nr.8321, datë 02.04.1998 “Për Policinë e Burgjeve” me ndryshimet përkatëse thuhet: *“Policia e Burgjeve i kryen detyrat e veta mbështetur në këtë ligj dhe në aktet e tjera nënligjore, që rregullojnë veprimtarinë e saj”.*

Ndërsa në pikën 2 të urdhërit të Ministrit të Drejtësisë, nr.3052/1 prot, datë 25.05.2005 *“Për miratimin e rregullores të sjelljes për punonjësit e sistemit të paraburgimit dhe të burgjeve”, thuhet : “Në realizimin e detyrave që u ngarkon ligji, punonjësit e paraburgimit dhe të burgjeve do të respektojnë dhe mbrojnë dinjitetin njerëzor, si dhe do të përkahin respektimin e të drejtave të çdo personi të privuar nga liria”.*

Duke analizuar në tërësi ngjarjen me provat e administruara rezultoi se:

Sjelljet e punonjësve të policisë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve nuk janë korrekte, aspak të hijshme, dhe të papërligjura, shoqëruar me kryerjen e kontrolleve fizike të të dënuarve apo të sendeve e orendive të dhomave. Disa prej të dënuarve ju kanë vendosur dhe pranga në duar, kurse të dënuarit H. T., i kanë hequr protezën e këmbës me dyshimin se në të kishte sende të kundërligjshme.

Kulmi i veprimeve të kundërligjshme të punonjësve të policisë së burgjeve është ushtrimi i dhunës fizike, nëpërmjet goditjes me grushte e shkop gome në pjesë të ndryshme të trupit pa marrë parasysh faktin specifik të IEVP Krujë se të dënuarit e atij institucioni paraqiten me probleme shëndetësore.

Kryerja e këtyre veprimeve nga punonjësit e policisë së burgjeve gjatë ushtrimit të detyrës, i kapërthen kompetencat dhe si e tillë është e kundërligjshme me pasoja në shëndetin e shtetasve dhe cënimin e dinjitetit të tyre njerëzor.

Për rrjedhojë nëpërmjet kryerjes së veprimeve flagrante të dhunshme ndaj të dënuarve, punonjësit e policisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve Fatmir Kaceli etj, gjatë ushtrimit të detyrës, ka dyshime të arsyeshme e të bazuara se ata kanë kryer veprën penale të “Kryejres së veprimeve arbitrare” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal.

Objekti i veprës penale të mësipërme janë marrëdhënie juridike të vendosura për të siguruar veprimtarinë e rregullt shtetërore ose shërbimin publik, që kanë të bëjnë me lirinë e shtetasve, të mbrojtura posaçërisht me legjislacionin penal, nga veprimet ose mosveprimet kriminale.

Për zhvillimin e një hetimi të gjithanshëm dhe objektiv, do të sugjerohet:

a. Identifikimin e punonjësve të policisë të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve të cilët më datën 28.07.2015, kanë ushtruar kontroll në mjediset e rregjimit të brendshëm në IEVP “Zahari” Krujë.

b.Pas marrjes së deklarimeve të personave të dënuar, dëmtuar nga ushtrimi i dhunës fizike si, R. H., etj, bazuar në nenin 171 e në vijim të Kodit të Procedurës Penale të realizohet me ta njohja e personave, punonjës të policisë së burgjeve.

c.Të merren deklarime të punonjësve të policisë së IEVP “Zahari” Krujë” të cilët kanë qënë në punë në rregjimin e brëndshëm datë 28 Korrik 2015, pasi të dënuarit e dëmtuar nga dhuna kanë kërkuar ndihmë mjekësore.

ç. Të merren deklarime dhe personelit të shërbimit mjekësor për dijeninë që kanë për ngjarjen, veprimet e kryera gjatë vizitave të të dëmtuarve dhe pasqyrimin e tyre në rregjistrat e vizitave apo kartelën klinike të dënuarit.

d.Të administrohen aktet që lidhen me urdhërin e nxjerrë për kryerjen e kontrollit nga punonjësit e Policisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, konstatimet e tyre pas kontrollit, komunikata e nxjerrë për këtë qëllim etj.

Për sa më sipër dhe bazuar në nenin 63, pika 3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë ku thuhet: *“Avokati i Popullit ka të drejtë të bëjë rekomandime dhe të propozojë masa kur vëren shkelje të drejtave të njeriut nga administrate publike”* dhe në bazë të nenit 21 gërma “ç” të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit” me ndryshimet përkatëse ku thuhet: *“Avokati i Popullit pas përfundimit të hetimit, i rekomandon Prokurorisë të fillojë hetimet në qoftë se vëren se është konsumuar figura e një vepre penale, ose të rifillojë hetimet e pushuara ose të pezulluara”,*

RE KOMANDOJMË

“Fillimin e hetimit të procedimit penal për veprën penale “Kryerja e veprimeve arbitrare” në bashkëpunim, parashikuar nga neni 250 e 25 të Kodit Penal, në ngarkim të punonjësve të policisë së Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve F. K., etj, në dëm të dënuarve R. H., B. Çela., F. B., dhe H. T., të cilët janë duke vuajtur dënimin në IEVP “Zahari” Krujë.

Për qëndrimin që do të mbani dhe masat që do të merrni në zbatim të këtij Rekomandimi, lutemi na njoftoni brënda afatit ligjor prej 30 ditë, e parashikuar në nenin 22 të ligjit “Për Avokatin e Popullit”.

Bashkëlidhur ju dërgojmë dokumentet e mëposhtme:

- 1.Proces verbal i marrjes së deklarimeve të dënuarve, shtetasve R. H., B. Ç., F. B., H. T., G. Sh., dhe F. T., datë 30.07.2015.
- 2.Kartela klinike nr.918, e të dënuarit F. L. B., i datëlindjes 07.06.1969.
- 3.Fletë nga rregjistri I vizitave të dënuarve në IEVP “Zahari” Krujë, datë 28-29.07.2015.

Duke besuar në mirëkuptimin tuaj.

AVOKATI I POPULLIT

Konc.&.Dakt.P.A.
Kom.A.SH.
Tiranë më 05.08.2015

Igli TOTOZANI

